



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
2. Dispozitat e Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe Nenit 4 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
3. Kërkesën e KOSTT SH.A për derrogim në zbatimin e disa dispozitave të Kodit të Rrjetit, të datës 26 janar 2009, dhe të korrigjuar me 13 shkurt 2009,

në seancën e mbajtur më 27 shkurt 2009 ka nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **I lejohet KOSTT SH.A.** derrogimi në zbatimin e dispozitave të neneve të **Kodit të Rrjetit**, si në **Shtojcë të këtij vendimi**.
2. Të gjitha dispozitat tjera të Kodit të do të mbesin në fuqi.

ARSYETIM

ZRRE me datë 26 janar 2009 ka pranuar kërkesën e KOSTT SH.A për derrogim në zbatimin e disa dispozitave të Kodit të Rrjetit dhe me 13 shkurt 2009 korrigjimin e së njëjtës. ZRRE gjatë vlerësimit të kërkesës dhe duke pasur parasysh gjendjen aktuale të sistemit të transmisionit ka pa të arsyeshme që të lejojë derrogimin në afatet e vendosura si në shtojcë.

3. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
4. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e lejimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
5. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e lëshimit të tij ose në datën e publikimit të tij në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
6. Vendimit i bashkëngjitet Shtojca - Derrogimet e lejuara;

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Dr. Nysret Avdiu, Anëtar

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar